



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 8 dhe nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës (Nr.6320/15 të datës 22.10.2015), Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e katërt të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 25.10.2024, merr këtë:

KONKLUZION

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Graçanicës e kundërshton marrjen e njëanëshme të Vendimit nr.05/218 nga Qeveria e Kosovës, të nxjerr në mbledhjen e Qeverisë më datën 28.08.2024, në pjesën që i referohet marrjes së pronësisë në parcelat, në pronësi të Komunës së Graçanicës.

Neni 2

Obligohet kryetarja e komunës që t'ia paraqesë Qeverisë së Kosovës kundërshtim ndaj Vendimit nr.05/218 të datës 28.08.2024 dhe të kërkojë ndryshimin e pjesëshëm të Vendimit në paragrafin 3, me përjashtim të veçantë nga Vendimi të parcelës nr.17-8 ZK Graçanicë, në pronësi të Komunës së Graçanicës.

Neni 3

Obligohet kryetarja e komunës dhe drejtoritë kompetente komunale që t'i ndërmarrin veprimet e tjera të nevojshme para organeve, organizatave dhe institucioneve tjera, për të arritur qëllimin nga neni 2 i këtij Konkluzioni.

Neni 4

Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesqesi i Kuvendit:

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević